



URDHËR

Nr. 89, Datë 22 /12/2016

PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I
MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË
NEVOJË

Në zbatim të nenit 112, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, nenit 12, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të VKM nr____, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë",

URDHËROJ

1. Ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e aplikimeve të studentëve, për të përfituar bursë, për vitin akademik 2016 - 2017, me këtë përbërje:

- a) Yllka KUKUMI
- b) Besmira NEZAJ
- c) Vladimir DHAMO

Grupi i punës shprehet me shkrim për plotësimin e kriterëve për bursë nga studentët aplikant.

2. Studentët që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, në vitin akademik 2016-2017, dhe plotësojnë kriteret, si:

2.1. kriteri ekonomik:

- a) Studenti që vendbanimin e ka mbi 10 km nga vendbanimi i përhershëm, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
- b) Studenti, bashkëshort me fëmijë dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;





- b) Studenti me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

2.2. Jashtë kriterit ekonomik:

- a) Studentët që kanë përfituar **statusin e jetimit**;
b) Studentët që kanë **humbur përgjegjësinë prindërore**, me vendim gjykatë të formës së prerë;
c) Studentët që janë identifikuar **e trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore** dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
ç) Studentët **që rezultojnë fëmijë të punonjësve** të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

2.3 Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfitimit në rast se:

- a) **janë ndarë** nga trangu familjar;
b) familjet e tyre **ushtrojnë veprimtari private**;
c) vazhdojnë **studimet në një program të dytë studimi**;
ç) **shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese**;
d) **nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij**, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.

2.5. Kriteri, rezultate të arritura në studime:

- a) Studentët e që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, **në vitin e parë të**, të vitit akademik 2016-2017, dhe që janë shpallur nga MAS **më të mirët e Maturës Shtetërore**. Kjo listë hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve;
b) Për studentët e regjistruar në vitet **pas të parit**, notë mesatare maksimale do **të konsiderohet nota 10 (dhjetë)**, e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. **Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.**

3. Bursat për vitet e tjera, **pas vitit të parë të studimeve**, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga UAR, **për çdo student që rezulton student në nevojë**. Njësia e qeverisjes vendore pajis studentët me dokumentacionin ligjor që vërteton gjendjen për t'u konsideruar student në nevojë.
4. Studentët që ndjekin studimet në UAR **në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve**, që **nuk kanë përfituar bursë në vitin e parë akademik** dhe plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij urdhëri, **mund të përfitojnë bursë** brenda numrit të bursave të planifikuara dhe që administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë.
5. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për studentët e regjistruar në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2016-2017, **është data 31 Janar 2017.**





Për të gjitha kategoritë tjera të studentëve të regjistruar në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve në UAR, **është data 30 dhjetor 2016**. Për vitet akademike në vijim, afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për të gjitha kategoritë, për sa më sipër, **është jo më vonë se muaji dhjetor i vitit përkatës akademik**.

6. Urdhërat, e **Administratorit/Kancelarit** për miratimin e bursave të studentëve të **bëhen publike**, nëpërmjet publikimit në faqet e web të Universitetit të Arteve, në **rubrikën "Njoftime"** dhe pranë Sekretarive mësimore të fakulteteve të UAR;
7. Dokumentacionin që duhet të plotësojë studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, që kanë përfunduar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).
 - a) Fotokopje e kartës së ID;
 - b) Lista e notave, e firmosur nga K/sekretaret dhe Dekani i Fakultetit dhe e vulosur;
 - c) Kërkesë e studentit.

Këto dokumenta K/Degëve të administrimit, pranë fakulteteve i dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike të Rektoratit, tek znj.Yllka KUKUMI.

8. Studentët sipas kriterit ekonomik, **të vitit të parë** i drejtohen Këshillit të Bashkisë, për përfitim burse:

- a) Letër motivimi ku të shpjegohet arsyeja e aplikimit, drejtuar Këshillit të Bashkisë;

9. Studentët e **vitet të dyta dhe të tretë**, që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, sipas kriterit ekonomik (pikës 2.1) të këtij urdhëri, dokumentacionin e dorëzojnë tek K/Degëve të administrimit pranë fakulteteve dhe këta të fundit i dorëzojnë në Drejtorisë Ekonomike të Rektoratit, tek znj.Yllka KUKUMI, **brenda orës 14⁰⁰**, çdo ditë pune, deri në **datën 30/12/2016**. I gjithë dokumentacioni të jetë i tre muajve të fundit.

- 1) Letër motivimi ku të shpjegohet arsyeja e aplikimit;
- 2) Vërtetim nga fakulteti që është student;
- 3) Fotokopje e kartës së ID;
- 4) Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit (trungu familjar);
- 5) Vërtetim nga ISSH (për të gjithë pjestarët e familjes për të vërtetuar nëse përfitojnë ndonjë lloj pensioni).
- 6) Vërtetim nga Njësia e qeverisjes vendore, për ndihmën ekonomike, me emrin e K/familjarit;
- 7) Vërtetim të pagës mujore për secilin anëtar të familjes në marrëdhënie pune, nga qendrat e tyre të punës;
- 8) Vërtetim nga Zyrat Vendore e Punësimit, nëse figuron si i papunë për çdo anëtar të familjes;
- 9) Vërtetim nga zyra e përkrahjes sociale pranë njësive të qeverisjes vendore, për çdo person sipas certifikatës familjare, që ka mbushur 18 vjeç. Vërtetimi të ketë numrin e kartelës;
- 10) Në rast se prindrit janë në pension, vërtetim nga Dega e Sigurimeve Shoqërore të rrethit, për pagesën e pensionit, kompensimet, etj., Vërtetimi të ketë numrin e kartelës së pensionit;





- 11) Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, që vërteton se anëtarët e familjes së studentit nuk ushtrojnë aktivitet privat;
- 12) Për motrat dhe vëllezërit që janë në shkollë, vërtetim nga shkolla nëse gëzojnë bursë ose jo;
- 13) Vërtetim nga ZVRPP (zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të palujtshme), për të gjithë anëtarët e familjes, sipas certifikatë, që me pronat e palujtshme nuk krijojnë të ardhura;
- 14) Vërtetim nga zyra e Kadastrës për tokën;
- 15) Vërtetim nga Institucionet Shtetërore, për anëtar e familjes, që janë ushtar, jashtë shtetit;
- 16) Deklaratë nga K/familjari, për dokumentacionin e studentit;
- 17) Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore (Vendimin e Gjykatës);
- 18) Secili nga studentët bashkëshortë me fëmijë që plotësojnë kriterin ekonomik;
- 19) Studentët, me aftësi të kufizuar (Vendim nga KMCAJ, Dëshmi zyrtare identifikimi, Raporti mjeksor i lëshuar nga KMCAJ/ Vërtetim nga DSSH dhe gjithë dokumentacionin e përmendur;
- 20) Dokumenti nga Institucionet Shtetërore, për Statusin Jetim.

10. Në çdo rast, kur një aplikues student mund të ketë përfituar bursë për vitin akademik 2016 - 2017, me dokumentat shoqërues justifikues, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjore, përgjegjësia bje mbi studentin i cili do të penalizohet sipas legjislacionit në fuqi.

11. Mos dorëzimi i të gjithë dokumentacionit sipas pikave 2.1. dhe 9 të këtij urdhëri, e bën të pavlefshme aplikimin.

12. Çdo student aplikues, në rast se i refuzohet kërkesa ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

13. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numëri i bursave për studentët administrohet nga UART (Drejtoria ekonomike).

14. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve brenda dates 22 dhjetor 2016, në rubrikën "Njoftime" dhe në vende të dukshme në fakultete e UART;

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhër, Dekanët e Fakulteteve, Kancelari, Drejtoria Ekonomike, Sekretarët e Fakulteteve, K/Dega në fakultet, Sektori Mësimor, Sektori i Statistikës dhe Informacionit, Sektori juridik dhe studenti aplikant.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE